

UDHËZUES

Organizimi i Festivalit të Shkencës

me nxënësit e arsimit të mesëm të lartë për vitin shkollor 2025–2026



Udhëzuesi për organizimin e Festivalit të Shkencës për nxënësit e arsimit të mesëm të lartë është hartuar nga grupi i punës, i përbërë nga specialistë të Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), si dhe nga mësues të matematikës, të shkencave të natyrës dhe të TIK-ut në arsimin parauniversitar. Udhëzuesi është konsultuar dhe përmirësuar me kontributin e grupit qendror, të ngritur pranë Ministrisë së Arsimit (MA), me qëllim sigurimin e një kuadri të qartë dhe funksional për organizimin dhe zhvillimin e Festivalit të Shkencës në nivel kombëtar. Hartimi i këtij udhëzuesi mbështetet në urdhrin e Ministrisë së Arsimit nr. 585, datë 13.11.2025, “Për organizimin e Festivalit të Shkencës me nxënësit e arsimit të mesëm të lartë për vitin shkollor 2025–2026”.

SHKURTESA

MA - Ministria e Arsimit

ASCAP - Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar

AKAP - Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar

DRAP - Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar

ZVAP - Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar

STEM - Shkencë, Teknologji, Inxhinieri dhe Matematikë

STEAM - Shkencë, Teknologji, Inxhinieri, Art dhe Matematikë

AML - Arsimi i Mesëm i Lartë

TIK - Teknologji e Informacionit dhe e Komunikimit

IA - Inteligjenca Artificiale

TABELA E PËRMBAJTJES

I. HYRJE.....	5
II. STRUKTURA E UDHËZUESIT	6
III. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E FESTIVALIT TË SHKENCËS	7
IV. ORGANIZIMI I FESTIVALIT TË SHKENCËS	8
V. PROJEKTI NË KUADËR TË FESTIVALIT TË SHKENCËS.....	16
VI. TIPOLOGJITË DHE FUSHAT E PROJEKTEVE	18
VII.DOKUMENTI I SHKRUAR I PROJEKTIT NË KUADËR TË FESTIVALIT TË SHKENCËS.....	24
VIII.PREZANTIMI I PROJEKTIT	27
IX. EKIPI ET E NXËNËSVE DHE RREGULLAT E FESTIVALIT	29
X. ROLI I INSTITUCIONEVE NË ORGANIZIMIN DHE NË ZHVILLIMIN E FESTIVALIT TË SHKENCËS	33
XI. KRITERET DHE VLERËSIMI I PROJEKTEVE	37
XII. ÇMIMET DHE FINALIZIMI I FESTIVALIT	43
XIII.BIBLIOGRAFIA	44
XIV.SHTOJCA.....	45

I. HYRJE

Në një kontekst shoqëror dhe global ku shkenca, teknologjia dhe inovacioni po ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik, mjedisor dhe social, arsimi parauniversitar ka misionin të përgatisë nxënës që jo vetëm zotërojnë njohuri teorike, por janë të aftë t'i zbatojnë ato në situata reale përmes mendimit kritik, kërkimit shkencor, eksperimentimit dhe bashkëpunimit. Në këtë kuadër, nxënësit e arsimit të mesëm të lartë marrin një rol të ri si krijues, studiues dhe zgjidhës të sfidave komplekse të së tashmes dhe së ardhmes.

Pikërisht këtij qëllimi i shërben Festivali Kombëtar i Shkencës, një nismë kombëtare e Ministrisë e Arsimit për nxënësit e shkollave të mesme, e cila synon të shndërrojë shkollat në qendra krijimtari dhe inovacioni. Festivali krijon hapësira të strukturuar ku nxënësit prezantojnë projekte kërkimore, eksperimente, prototipe inxhinierike dhe zgjidhje digjitale, të zhvilluara nga vetë ata përmes projekteve praktike dhe hulumtimeve të pavarura.

Festivali shërben si një platformë e hapur për prezantimin e ideve dhe produkteve shkencore që dëshmojnë aftësinë e nxënësve për të zbatuar njohuritë shkencore në mënyrë kritike, krijuese dhe bashkëpunuese. Përmes këtij aktiviteti synohet rritja e interesit të të rinjve për shkencën dhe teknologjinë, zhvillimi i aftësive analitike dhe komunikuese, si dhe forcimi i lidhjes ndërmjet arsimit parauniversitar, institucioneve universitare dhe kërkimore, si dhe sektorit privat.

Festivali Kombëtar i Shkencës përfaqëson një formë bashkëkohore të të nxënësve përmes projekteve dhe kërkimit shkencor, ku nxënësit marrin rolin e studiuesve, novatorëve dhe prezantuesve të ideve me ndikim praktik. Festivali i shkencës mbështetet në standarde dhe praktika ndërkombëtare të njohura, si Konkursi i Bashkimit Evropian për Shkencëtarët e Rinj (EUCYS), Panairi Ndërkombëtar i Shkencës dhe Inxhinierisë (ISEF), edukimi shkencor i bazuar në hetim (IBSE – UNESCO), si dhe qasjet bashkëkohore të inovacionit në kuadër të STEM/STEAM.

Nëpërmjet pjesëmarrjes në festival, nxënësit zhvillojnë aftësi kërkimore, analitike dhe komunikuese, forcojnë kompetencat shkencore, digjitale dhe qytetare, mësojnë të punojnë në ekip, të argumentojnë idetë e tyre dhe të propozojnë zgjidhje të bazuara në metoda shkencore. Festivali nxit gjithashtu mendimin krijues dhe ndërdisiplinor,

duke integruar fushat STEM dhe STEAM, si dhe përdorimin e teknologjive bashkëkohore, përfshirë inteligjencën artificiale.

Në Festivalin Kombëtar të Shkencës marrin pjesë nxënësit e arsimit të mesëm të lartë të shkollave publike dhe private (gjimnaze dhe shkolla të mesme të bashkuara), të organizuar në ekipe dhe të udhëhequr nga një mësues koordinatorë i përzgjedhur nga fushat përkatëse.

Festivali zhvillohet në tri faza të strukturuar, duke filluar nga në nivel shkolle, vijuar në nivel rajonal dhe duke përfunduar në nivel kombëtar.

Në vijim të reformave kurrikulare, investimeve në laboratorë dhe SmartLab, si dhe nismave për forcimin e arsimit shkencor dhe zhvillimin e kompetencave STEM/STEAM, Festivali Kombëtar i Shkencës synon të konsolidohet si një traditë vjetore e qëndrueshme. Ai shërben si mekanizëm për identifikimin, mbështetjen dhe afirmimin e talenteve të reja në shkenca, si dhe për ndërthurjen e sfidave shkencore me sfida aktuale të shoqërisë, si zhvillimi i qëndrueshëm, mbrojtja e mjedisit, inovacioni digjital dhe përdorimi i përgjegjshëm i teknologjisë në përmirësimin e cilësisë së jetës.

II. STRUKTURA E UDHËZUESIT

Udhëzuesi për organizimin e Festivalit Kombëtar të Shkencës është hartuar në mënyrë të tillë që të shërbejë si një dokument orientues dhe praktik për të gjithë aktorët e përfshirë në organizimin dhe zhvillimin e festivalit në të gjitha fazat e tij. Struktura e udhëzuesit synon të sigurojë qartësi në zbatimin e procedurave, koherencë në organizim dhe një kuptim të përbashkët të roleve dhe përgjegjësiwe institucionale.

Udhëzuesi përmban seksionet kryesore të mëposhtme:

- **Qëllimi dhe objektivat e Festivalit Kombëtar të Shkencës**, ku përcaktohen objektivat kryesore dhe drejtimet që udhëheqin organizimin e festivalit.
- **Organizimi i Festivalit të Shkencës**, ku përshkruhet mënyra e zhvillimit të festivalit në faza të njëpasnjëshme, në nivel shkolle/ZVAP, DRAP-i dhe kombëtar, si dhe afatet përkatëse.
- **Projekti** në kuadër të Festivalit të Shkencës.

- *Tipologjitë dhe fushat e projekteve*, ku përcaktohen llojet e projekteve që mund të paraqiten nga nxënësit dhe fushat tematike në të cilat ato zhvillohen.
- *Dokumenti i shkruar i projektit* në kuadër të Festivalit të Shkencës.
- *Prezantimi i projekteve* gjatë Festivalit të Shkencës.
- *Rregullat e pjesëmarrjes dhe përbërja e ekipeve*, ku saktësohen kriteret për përfshirjen e nxënësve, mësuesi koordinator dhe kërkesat për dokumentacionin shoqërues.
- *Roli i institucioneve* në organizimin e Festivalit të Shkencës.
- *Procedura e vlerësimit dhe kriteret për vlerësimin e projekteve*, ku përcaktohen parimet, mënyra e vlerësimit dhe roli i jurisë në çdo fazë të festivalit.
- *Çmimet dhe finalizimi i Festivalit Kombëtar të Shkencës*, ku përshkruhet mënyra e shpalljes së fituesve dhe kategoritë e çmimeve.
- *Shtojcat*, të cilat përfshijnë modelet e dokumenteve shoqëruese, formatet e vlerësimit dhe materialet orientuese për zbatimin e festivalit.

III. QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E FESTIVALIT TË SHKENCËS

Festivali Kombëtar i Shkencës ka si qëllim të promovojë kulturën shkencore, qasjen eksploruese dhe krijimtarinë inovative të nxënësit të arsimit të mesëm të lartë, duke i angazhuar ata në zgjidhjen e situatave praktike përmes metodave shkencore, përdorimit të teknologjisë dhe bashkëpunimit ndërdisiplinor. Ky aktivitet synon të kontribuojë në zhvillimin e një kulture bashkëkohore të të nxënësve, në evidentimin e talenteve dhe ideve inovative, si dhe në forcimin e bashkëpunimit ndërmjet shkollave, institucioneve arsimore, universiteteve dhe partnerëve të tjerë.

Objektivat e festivalit

- Të nxisë kuriozitetin shkencor dhe të zhvillojë aftësinë e nxënësve për të menduar në mënyrë kritike, krijuese dhe analitike, duke i orientuar drejt zgjidhjes së problemeve reale përmes dijes shkencore.
- Të forcojë aftësitë kërkimore dhe eksperimentale përmes punës praktike, hulumtimeve dhe prezantimeve të bazuara në metoda shkencore.

- Të promovojë bashkëpunimin ndërlëndor dhe lidhjen ndërmjet disiplinave të ndryshme të shkencës, teknologjisë, inxhinierisë dhe mjedisit, duke nxitur qasje integruese në të nxënë.
- Të nxisë përdorimin e teknologjisë dhe inovacionit, përfshirë mjetet digjitale, laboratorët dhe zgjidhjet e bazuara në IA, në funksion të të nxënit dhe krijimit;
- Të krijojë ura bashkëpunimi ndërmjet shkollave, universiteteve, institucioneve të kërkimit shkencor dhe sektorit privat, me qëllim mbështetjen e talenteve të reja dhe shkëmbimin e përvojave.
- Të identifikojë, evidentojë dhe mbështesë talentet e reja shkencore në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar, duke u dhënë atyre mundësi për afirmim dhe zhvillim profesional.
- Të kontribuojë në forcimin e kompetencave në matematikë, shkencë, teknologji dhe inxhinieri, kompetencës digjitale, kompetencës qytetare dhe asaj të sipërmarrjes.

Përmes këtij qëllimi dhe objektivave, Festivali Kombëtar të Shkencës synon të kontribuojë në formimin e nxënësve si qytetarë aktivë, të informuar dhe të përgatitur për sfidat akademike, profesionale dhe shoqërore të së ardhmes.

IV. ORGANIZIMI I FESTIVALIT TË SHKENCËS

Festivali Kombëtar i Shkencës organizohet dhe zhvillohet në të gjitha shkollat e mesme publike dhe private përmes një procesi të strukturuar, të ndarë në faza të njëpasnjëshme organizimi dhe vlerësimi. Ky proces siguron që projektet shkencore të zhvilluara nga nxënësit të prezantohen, të shqyrtohen dhe të vlerësohen në mënyrë progresive, duke respektuar parime dhe kritere vlerësimi në çdo nivel të festivalit. Zhvillimi i festivalit në disa faza synon të nxisë pjesëmarrjen aktive të nxënësve, të mbështesë zhvillimin progresiv të projekteve dhe të sigurojë një proces të qartë përzgjedhjeje për fazat pasuese. Çdo fazë ka rolin e saj specifik në identifikimin e ideve dhe projekteve më cilësore, duke marrë parasysh kriteret e përcaktuara në këtë udhëzues.

Përmes këtij organizimi, festivali shërben jo vetëm si aktivitet konkurrues, por edhe si një proces edukativ i vazhdueshëm, ku nxënësit kanë mundësi të përmirësojnë

projektet e tyre, të marrin përvojë në prezantim dhe të përfitojnë nga bashkëpunimi me mësuesit koordinatorë dhe institucionet arsimore në nivele të ndryshme. Festivali Kombëtar i Shkencës zhvillohet në *tri faza kryesore*, të cilat përshkruhen më poshtë.

1. **Faza I:** Përzgjedhja e projekteve dhe konkurrimi në nivel shkolle dhe në nivel ZVAP-i
2. **Faza II:** Përzgjedhja e projekteve dhe konkurrimi në nivel DRAP-i
3. **Faza III:** Përzgjedhja e projekteve dhe konkurrimi në Finalen e Festivalit Kombëtar të Shkencës

FAZA I: PËRZGJEDHJA E PROJEKTIT DHE KONKURRIMI NË NIVEL SHKOLLE DHE NË NIVEL ZVAP-i

Faza e parë e Festivalit Kombëtar të Shkencës shërben si etapa fillestare e organizimit dhe e përzgjedhjes së projekteve shkencore. Në këtë fazë, nxënësit, të organizuar në ekip që nga fillimi i procesit, prezantojnë projektet e tyre në nivel shkolle dhe më pas në nivel vendor, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë udhëzues.

Qëllimi i kësaj faze është:

- të krijojë hapësirë për prezantimin e projekteve shkencore të zhvilluara nga nxënësit;
- të sigurojë një proces të strukturuar përzgjedhjeje në nivel lokal;
- të identifikojë projektet që plotësojnë kriteret për të vijuar në fazat pasuese të festivalit.

Faza e parë ndahet në *dy nën-faza*:

A. NËN-FAZA E PARË: Prezantimi dhe përzgjedhja e projekteve në nivel shkolle.

Periudha: janar 2026 – 27 shkurt 2026

Në këtë nën-fazë, çdo shkollë e mesme publike dhe private organizon një aktivitet të brendshëm prezantimi, në formën e një mini-panairi shkencor, ku ekipet e nxënësve prezantojnë projektet e tyre përpara një komisioni vlerësimi të ngritur në nivel shkolle.

Në mini-panair marrin pjesë ekipe të nxënësve nga të gjitha klasat 10 ose 11 ose 12. Kjo nënkupton që ekipi i nxënësve mund të jetë nga e njëjta klasë, por ekipi i nxënësve mund të jetë edhe nga klasa të ndryshme.

Për organizimin e mini – panairit shkencor në nivel shkolle, drejtorja e shkollës:

- njofton nxënësit lidhur me zhvillimin e festivalit të shkencës;
- organizon takim me ekipet kurrikulare në fushën e matematikës, shkencave të natyrës (fizikë, biologji, kimi), TIK, si dhe me mësuesin koordinator të sigurimit të cilësisë (MKSC) në lidhje me projektet kurrikulare të zhvilluara nga nxënësit;
- fton ekipet e nxënësve që së bashku me mësuesin koordinator përkatës sipas profilit të përmirësojnë projektet e tyre shkencore sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzuesin për Festivalin Kombëtar të Shkencës;
- formon një juri të brendshme për vlerësimin e projekteve që përmbushin kriteret për pjesëmarrje në Festivalin e Shkencës;
- cakton datën për organizimin e festivalit të shkencës në nivel shkolle dhe njofton ZVAP-in përkatës.
- organizon mini – panairin me prezantimet e projekteve nga ekipet e nxënësve në mjedise të përcaktuara nga drejtorja e shkollës;
- shpall projektet e përzgjedhura nga juria në nivel shkolle, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë udhëzues, për pjesëmarrje në Festivalin e Shkencës;
- dorëzon procesverbalin me listën e projekteve fituese në ZVAP-in përkatës.

Juria në nivel shkolle formohet nga drejtorja e shkollës dhe përbëhet nga:

- ✓ një drejtues i shkollës (preferohet profili shkencor);
- ✓ mësuesi koordinator i sigurimit të cilësisë (MKSC);
- ✓ një mësues i fushave të shkencave, teknologjisë ose TIK-ut.

Në përfundim të kësaj nën - faze, juria përzgjedh nga *një deri në tri projekte* përfaqësuese të shkollës, të cilat kualifikohen për të marrë pjesë në nën – fazën pasardhëse, në nivel ZVAP-i.

Çdo projekt përfaqësohet nga:

- një ekip prej 3–5 nxënësish;
- një mësues koordinator i fushës përkatëse, i cili mbështet nxënësit gjatë procesit të përgatitjes dhe prezantimit të projektit.

Çdo nxënës i ekipit që do të përfaqësojë projektin e shkollës në Festivalin e Shkencës, do të ketë të plotësuar deklaratën e pjesëmarrjes, të firmosur nga prindi/kujdestari (shtojca 1).

Zhvillimi i kësaj nën-faze monitorohet nga ZVAP-i.

B. NËN-FAZA E DYTË: Prezantimi dhe përzgjedhja e projekteve në nivel ZVAP-i

Periudha: 3 mars 2026 - 16 mars 2026

Në këtë nën-fazë, çdo Zyrë Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP) organizon Festivalin e Shkencës në nivel vendor, me pjesëmarrjen e shkollave të mesme brenda juridiksionit të saj.

ZVAP organizon Festivalin e Shkencës në një mjedis të përshtatshëm, ku nxënësit kanë mundësi të prezantojnë projektet e tyre përpara jurisë vlerësuese dhe publikut të ftuar, si nxënës, mësues, prindër dhe partnerë të tjerë lokalë.

Për organizimin e festivalit shkencor në nivel vendor, ZVAP:

- cakton një koordinator në nivel ZVAP-i, i cili ka përgjegjësi për planifikimin dhe mbështetjen e procesit organizativ të festivalit;
- njofton drejtuesit e shkollave lidhur me zhvillimin e festivalit të shkencës;
- organizon takim me ekipet e nxënësve dhe mësuesit koordinatorë që i udhëheqin ata në lidhje me kriteret e projekteve që do të prezantohen në Festivalin e Shkencës, si dhe mundësitë për përmirësimin e tyre;
- formon jurinë e festivalit në nivel vendor;
- cakton mjedisin e përshtatshëm për organizimin e festivalit të shkencës në nivel vendor;
- cakton datën për organizimin e festivalit të shkencës në nivel vendor dhe njofton DRAP-in përkatës, si dhe AKAP-in;
- formon jurinë e festivalit në nivel vendor në bashkëpunim me DRAP-in përkatës dhe AKAP-in;
- organizon Festivalin e Shkencës me prezantimet e projekteve të zhvilluara nga ekipet e nxënësve;
- shpall projektet e përzgjedhura nga juria në nivel vendor, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë udhëzues;
- dorëzon procesverbalin me listën e projekteve fituese në DRAP-in përkatës.

Juria në nivel ZVAP përbëhet nga:

- ✓ një përfaqësues i ZVAP-it;
- ✓ një përfaqësues i DRAP-it;
- ✓ një përfaqësues i ASCAP-it ose AKAP-it.

Në ditën e përcaktuar nga ZVAP, shkollat prezantojnë projektet e tyre. Në varësi të numrit të shkollave të mesme në juridiksionin përkatës të ZVAP-it, çdo shkollë mund të përfaqësohet nga një deri në tri projekte të realizuara nga ekipe të ndryshme nxënësish.

Çdo projekt përfaqësohet nga:

- një ekip prej 3–5 nxënësish;
- një mësues koordinator i fushës përkatëse të shkencave, teknologjisë ose TIK-ut.

Nxënësit prezantojnë projektin e tyre kryesor në stendat përkatëse, të shoqëruara me materiale pamore, fletëpalosje ose broshura përfaqësuese të shkollës. Nëse është e mundur, ekipet të përdorin edhe elemente identifikuese (uniformë shkolle ose uniformë me logo të projektit).

Projektet vlerësohen nga juria në bazë të kriterëve dhe të pikëzimit, të përcaktuar në shtojcën 3 dhe në shtojcën 4 të këtij udhëzuesi. Vlerësimi synon të evidentojë projektet që plotësojnë kriteret për të vijuar në fazën rajonale të festivalit.

Në përfundim të kësaj nënfaze, juria në nivel ZVAP-i shpall gjithsej **1–2 projekte fituese**, të cilat kualifikohen për në fazën II – Festivalin Rajonal të Shkencës (nivel DRAP-i).

Zhvillimi i kësaj nën-faze monitorohet nga Ministria e Arsimit, ASCAP, AKAP dhe DRAP.

***Shënim.** Për DRAP-et që kanë numër të madh ZVAP-esh, përfaqësimi i secilit ZVAP është 1 projekt fitues. Për DRAP-et që kanë numër të vogël ZVAP-esh, përfaqësimi i secilit ZVAP është deri në 2 projekte fituese.*

FAZA II: KONKURRIMI NË NIVEL DRAP-i

Faza e dytë e Festivalit Kombëtar të Shkencës zhvillohet në nivel rajonal dhe organizohet nga Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP). Në këtë fazë marrin pjesë projektet fituese të përzgjedhura në nivel ZVAP-i, të cilat përfaqësojnë shkollat e mesme të juridiksionit përkatës.

Periudha: 17 mars 2026 – 3 prill 2026

Qëllimi i kësaj faze është të krijojë një hapësirë më të gjerë prezantimi dhe vlerësimi të projekteve shkencore, të nxisë shkëmbimin e përvojave ndërmjet shkollave dhe të përzgjedhë projektet më cilësore që do të vijojnë në fazën kombëtare të festivalit.

Për organizimin e kësaj faze, DRAP-i:

- cakton një koordinator rajonal, i cili ka përgjegjësi për planifikimin dhe për mbështetjen e procesit organizativ të festivalit;
- njofton të gjitha ZVAP-et sipas juridiksionit lidhur me zhvillimin e festivalit të shkencës;
- organizon takim me koordinаторët e ZVAP-eve dhe mësuesit koordinatorë të projekteve që do të marrin pjesë në nivel rajonal në lidhje me kriteret e projekteve që do të prezantohen në Festivalin e Shkencës, si dhe mundësitë për përmirësimin e tyre;
- formon jurinë e festivalit në nivel rajonal;
- cakton mjedisin e përshtatshëm për organizimin e festivalit të shkencës në nivel rajonal, ku nxënësit të kenë mundësi të prezantojnë projektet e tyre përpara jurisë dhe publikut të ftuar;
- cakton datën për organizimin e festivalit të shkencës në nivel rajonal dhe njofton AKAP-in.
- formon jurinë e festivalit në nivel vendor në bashkëpunim me AKAP-in;
- organizon Festivalin e Shkencës me prezantimet e projekteve të zhvilluara nga ekipet e nxënësve;
- shpall projektet e përzgjedhura nga juria në nivel rajonal, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë udhëzues;
- dorëzon procesverbalin me listën e projekteve fituese në AKAP.

Në nivel rajonal formohet juria e festivalit, e cila përbëhet nga katër anëtarë, si më poshtë:

- ✓ një përfaqësues i Ministrisë së Arsimit ose i AKAP-it;
- ✓ një përfaqësues i ASCAP-it;
- ✓ një pedagog ose ekspert i fushës së shkencave;
- ✓ një përfaqësues partner (nëse është e mundur)

Në ditën e përcaktuar nga DRAP-i, ekipet e nxënësve prezantojnë projektet e tyre përpara jurisë rajonale dhe të ftuarve, të cilët mund të jenë nxënës, mësues, prindër, pedagogë, partnerë apo përfaqësues të institucioneve të tjera arsimore.

Çdo shkollë përfaqësohet nga:

- një ekip prej 3–5 nxënësish;
- një mësues koordinator i fushës së shkencave, teknologjisë ose TIK-ut.

Ekipet prezantojnë projektet e tyre përmes stendave ekspozuese, materialeve vizuale dhe shpjegimit të procesit të punës dhe rezultateve të arritura. Nxënësit mund të përdorin postera, fletëpalosje ose broshura informuese për të mbështetur projektin e tyre.

Projektet vlerësohen nga juria rajonale mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në shtojcën 3 dhe në shtojcën 4 në udhëzuesin e përgatitur nga ASCAP. Vlerësimi realizohet mbi bazën e *cilësisë* së projektit dhe *nuk ndikohet nga parimi i përfaqësimit të ZVAP-ve*.

Në përfundim të kësaj faze, juria rajonale shpall **4–5 projekte** fituese, të cilat kualifikohen për fazën e tretë të Festivalit Kombëtar të Shkencës, në nivel kombëtar.

Kjo fazë monitorohet nga Ministria e Arsimit, ASCAP dhe AKAP.

FAZA III: KONKURRIMI NË FESTIVALIN KOMBËTAR TË SHKENCËS

Faza e tretë kulmon me finalen e Festivalit Kombëtar të Shkencës dhe zhvillohet në Tiranë në një datë të caktuar nga ministria përgjegjëse për arsimin, si një ngjarje kombëtare për promovimin e projekteve më cilësore shkencore të nxënësve të arsimit të mesëm të lartë. Në këtë fazë marrin pjesë projektet fituese të përzgjedhura nga të gjitha Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP), në një numër orientues prej 20–25 projektesh.

Gjatë finales kombëtare, nxënësit prezantojnë projektet e tyre në stenda shkencore interaktive, ku demonstrojnë procesin e punës, metodologjinë e ndjekur dhe rezultatet e arritura. Prezantimi realizohet përpara jurisë kombëtare dhe publikut të ftuar, duke e shndërruar festivalin në një panair kombëtar të shkencës dhe inovacionit. Aktiviteti shoqërohet me sesione tematike, diskutime me ekspertë, si dhe veprimtari të tjera që promovojnë shkencën, teknologjinë dhe kërkimin shkencor të rinjtë.

Periudha: 6 prill 2026 – 30 prill 2026

Për organizimin e fazës finale:

- AKAP përcakton një koordinator përgjegjës për mbështetjen dhe koordinimin e aspektit organizativ të festivalit në nivel kombëtar.
- AKAP njofton të gjitha DRAP-et dhe ZVAP-et pjesëmarrëse lidhur me zhvillimin e festivalit të shkencës;
- ASCAP organizon takim me koordinatorët e DRAP-eve dhe AKAP-in në lidhje me kriteret e projekteve që do të prezantohen në Festivalin e Shkencës, si dhe mundësitë për përmirësimin e projekteve të nxënësve që do të marrin pjesë në finalen e Festivalit Kombëtar të Shkencës.
- Ministria e Arsimit (MA) formon jurinë kombëtare të festivalit, e cila përbëhet nga katër anëtarë:
 - ✓ një përfaqësues i MA/ ASCAP-it;
 - ✓ një pedagog ose ekspert i fushave të shkencave;
 - ✓ një përfaqësues nga bizneset inovative ose ekspert në fushën e shkencës dhe inovacionit;
 - ✓ një përfaqësues i donatorëve ose partnerëve mbështetës.
- Ministria e Arsimit në bashkëpunim me partnerët mbështetës, përzgjedh një mjedis të përshtatshëm dhe funksional për zhvillimin e finales kombëtare, i cili krijon mundësi për prezantimin e projekteve dhe ndërveprimin mes nxënësve, jurisë dhe publikut.

Në ditën e përcaktuar nga MA, projektet prezantohen nga ekipet përfaqësuese të shkollave. Çdo projekt përfaqësohet nga:

- një ekip prej 3–5 nxënësish;
- një mësues koordinator

Nxënësit prezantojnë projektin e tyre të shoqëruar me materiale pamore, fletëpalosje ose broshura përfaqësuese të shkollës, duke respektuar rregullat e përcaktuara në këtë udhëzues. Projektet vlerësohen nga juria kombëtare mbi bazën e pikëve të grumbulluara, sipas kritereve të përcaktuara në shtojcën 3 dhe në shtojcën 4 në udhëzuesin e përgatitur nga ASCAP. Në përfundim të vlerësimit, juria shpall projektet fituese në nivel kombëtar, sipas kategorive dhe çmimeve të parashikuara.

V. PROJEKTI NË KUADËR TË FESTIVALIT TË SHKENCËS

Në kuadër të Festivalit Kombëtar të Shkencës, *projekti* përfaqëson një veprimtari të strukturuar kërkimore, eksperimentale, inxhinierike ose digjitale, të zhvilluar nga nxënësit e arsimit të mesëm të lartë, me qëllim zgjidhjen e një problemi konkret, shqyrtimin e një dukurie shkencore ose krijimin e një zgjidhjeje inovative të bazuar në metoda shkencore dhe teknologjike. Projekti synon të lidhë njohuritë teorike të përfituara në shkollë me situata reale të jetës së përditshme, të shkollës ose të komunitetit, duke i dhënë nxënësit rol aktiv në procesin e të nxënës.

Projekti është produkt i *punës aktive, bashkëpunuese dhe krijuese të nxënësve* dhe përfshin procesin e plotë të të nxënës të bazuar në projekte dhe hulumtim shkencor. Ky proces nis me identifikimin e problemit ose të sfidës, vijon me formulimin e qëllimit dhe/ose hipotezës, përzgjedhjen e metodologjisë së përshtatshme, mbledhjen dhe analizën e të dhënave përmes mjeteve shkencore dhe teknologjike dhe përfundon me nxjerrjen e përfundimeve të argumentuara dhe prezantimin e qartë të rezultateve. Përmes këtij procesi, nxënësit zhvillojnë mendimin kritik, aftësitë analitike, komunikimin shkencor dhe përgjegjësinë për punën e tyre, duke u përgatitur për studime të mëtejshme dhe për përfshirje aktive në shoqërinë e bazuar në dije.

Karakteristikat kryesore të projektit në kuadër të Festivalit të Shkencës

Projekti i paraqitur në Festivalin e Shkencës duhet të jetë rezultat i një procesi të strukturuar kërkimi dhe pune praktike nga nxënësit dhe të dokumentojë qartë hapat e ndjekur gjatë zhvillimit të tij. Projekti duhet të zhvillohet nga nxënësit, në mënyrë aktive dhe bashkëpunuese, nën udhëheqjen dhe mbështetjen pedagogjike të mësuesit koordinator.

Në mënyrë të veçantë, projekti duhet:

- të jetë produkt i punës së nxënësve dhe të dokumentojë procesin e zhvillimit të tij;
- të bazohet në parimet e metodës shkencore dhe/ose në procesin e zgjidhjes inxhinierike/digjitale të problemeve;
- të demonstrojë mendim kritik, mendim krijues dhe qasje inovative;
- të ketë lidhje me situata reale të shkollës, komunitetit ose shoqërisë;
- të respektojë parimet e etikës shkencore, autorësinë dhe përdorimin korrekt të burimeve;
- të jetë i përshtatshëm për nivelin e arsimit të mesëm të lartë dhe për fushën tematike të përzgjedhur.

Projektet që nuk përmbushin këto karakteristika nuk kualifikohen për të vijuar në fazat pasuese të festivalit.

Nxënësit janë autorët kryesorë të projektit dhe mbajnë përgjegjësinë kryesore për realizimin e tij. Ata angazhohen në të gjitha hapat e zhvillimit të projektit, përfshirë:

- ✓ formulimin e idesë dhe përcaktimin e qëllimit të projektit;
- ✓ planifikimin dhe zbatimin e metodologjisë (eksperimentale, kërkimore ose inxhinierike);
- ✓ realizimin e eksperimenteve, prototipeve ose produkteve digjitale;
- ✓ mbledhjen, analizën dhe interpretimin e të dhënave;
- ✓ përgatitjen e dokumentacionit të projektit dhe të materialeve prezantuese;
- ✓ prezantimin dhe argumentimin e projektit përpara jurisë dhe publikut.

Nxënësit duhet të demonstrojnë bashkëpunim në grup, përgjegjësi individuale dhe aftësi për të reflektuar mbi procesin dhe rezultatet e punës së tyre.

Mësuesi koordinator është udhëheqës dhe mbështetës në zhvillimin e projektit, pa zëvendësuar punën krijuese dhe kërkimore të nxënësve. Ai/ajo:

- ✓ orienton nxënësit në përzgjedhjen e temës dhe strukturimin e projektit;
- ✓ ofron këshillim pedagogjik dhe shkencor gjatë gjithë procesit;
- ✓ ndihmon nxënësit të respektojnë metodologjinë shkencore dhe kriteret e festivalit;
- ✓ monitoron ecurinë e punës dhe nxit reflektimin kritik;
- ✓ mbështet përgatitjen e prezantimit dhe dokumentacionit shoqërues;
- ✓ shoqëron ekipin e nxënësve në fazat e festivalit, sipas përcaktimeve të këtij udhëzuesi.

Mësuesi koordinator nuk ndërhyr në mënyrë të drejtpërdrejtë në realizimin e projektit dhe nuk zëvendëson punën krijuese të nxënësve, por siguron që procesi të zhvillohet në mënyrë të rregullt, etike dhe cilësore.

VI. TIPOLOGJITË DHE FUSHAT E PROJEKTEVE

Në kuadër të Festivalit Kombëtar të Shkencës, nxënësit e shkollave të mesme ftohen të zhvillojnë dhe të prezantojnë projekte që pasqyrojnë kreativitetin, mendimin shkencor dhe aftësinë për të zbatuar dijet teorike në kontekste praktike.

Projektet mund të kenë forma dhe qëllime të ndryshme, duke reflektuar larmi qasjesh dhe fushash ndërdisiplinore.

TIPOLOGJITË E SUGJERUARA TË PROJEKTEVE

1. Projekte kërkimore shkencore

Projektet kërkimore shkencore janë projekte që përqendrohen në *hulumtimin sistematik të një problemi, dukurie ose pyetjeje kërkimore*, përmes mbledhjes, përpunimit dhe analizës së të dhënave. Këto projekte synojnë zhvillimin e aftësive kërkimore të nxënësve dhe zbatimin e metodës shkencore në mënyrë të strukturuar.

Projektet e kësaj tipologjie përfshijnë:

- ✓ formulimin e një pyetjeje kërkimore ose hipoteze;
- ✓ mbledhjen e të dhënave përmes vëzhgimeve, matjeve, pyetësorëve ose burimeve të besueshme;
- ✓ analizën statistikore të të dhënave;
- ✓ interpretimin e rezultateve dhe nxjerrjen e përfundimeve të argumentuara;
- ✓ paraqitjen e rezultateve në formë tabelash, grafikësh dhe përshkrimesh analitike.

Këto projekte janë të përshtatshme për fusha, si biologjia, mjedisi, shkencat sociale, matematika e aplikuar apo shëndeti publik.

2. Projekte inxhinierike / Prototipe dhe shpikje

Projektet inxhinierike dhe prototipet përqendrohen në *dizajnimin, ndërtimin dhe testimin e një zgjidhjeje teknike* që adreson një problem konkret. Ato demonstrojnë aftësitë praktike, krijimtarinë teknike dhe përdorimin e koncepteve shkencore në zgjidhje funksionale.

Projektet e kësaj tipologjie përfshijnë:

- ✓ identifikimin e një problemi teknik ose nevoje reale;
- ✓ projektimin e një zgjidhjeje (skica, plane, modele);
- ✓ ndërtimin e prototipit ose të pajisjes;
- ✓ testimin e funksionalitetit dhe përmirësimin e dizajnit;
- ✓ vlerësimin e zbatueshmërisë dhe ndikimit praktik.

Projektet mund të përfshijnë struktura mekanike, pajisje energetike, robotë të thjeshtë, sisteme automatike apo shpikje inovative për shkollën apo për komunitetin.

3. *Projekte eksperimentale*

Projektet eksperimentale bazohen në *kryerjen e një ose disa eksperimenteve shkencore*, me qëllim testimin e një hipoteze dhe verifikimin e marrëdhënieve ndërmjet variablave. Këto projekte zhvillojnë aftësitë e vëzhgimit, matjes dhe analizës eksperimentale.

Projektet të kësaj tipologjie përfshijnë:

- ✓ formulimin e një hipoteze të qartë;
- ✓ projektimin e eksperimentit dhe përcaktimin e variablave;
- ✓ përdorimin e mjeteve laboratorike ose të sensorëve;
- ✓ mbledhjen sistematike të të dhënave;
- ✓ analizën e rezultateve dhe interpretimin shkencor.

Projektet eksperimentale realizohen në kushte të sigurta dhe janë të përshtatshme për fizikë, kimi, biologji apo shkenca të mjedisit.

4. *Aplikacione dhe platforma digjitale*

Kjo tipologji përfshin projekte që lidhen me *krijimin e aplikacioneve, faqeve web, platformave digjitale ose algoritmeve* që adresojnë probleme reale në fusha si arsimi, mjedisi, shëndeti, komunikimi ose shërbimet sociale.

Projektet e kësaj tipologjie përfshijnë:

- ✓ identifikimin e një nevoje reale ose të një problemi social;
- ✓ dizajnimin e ndërfaqes dhe të funksioneve;
- ✓ zhvillimin e aplikacionit ose të platformës;
- ✓ testimin e funksionalitetit dhe përvojës së përdoruesit;
- ✓ paraqitjen e ndikimit dhe përdorimit praktik.

Ato zhvillojnë kompetencat digjitale, logjikën algoritmike dhe zgjidhjen e problemeve.

5. *Projekte teknologjike dhe digjitale (përfshirë IA)*

Projektet teknologjike dhe digjitale përqendrohen në **përdorimin e teknologjive të reja**, programimit, robotikës dhe inteligjencës artificiale për zgjidhjen e problemeve komplekse.

Këto projekte mund të përfshijnë:

- ✓ modele të thjeshta të inteligjencës artificiale (klasifikim, parashikim);
- ✓ sisteme automatike dhe robotikë;
- ✓ përpunim dhe analizë të të dhënave;
- ✓ integrim të sensorëve dhe IoT;
- ✓ përdorim etik dhe të përgjegjshëm të teknologjisë.

Projektet janë të orientuara drejt inovacionit dhe përgatitjes së nxënësve për teknologjitë e së ardhmes.

6. *Punime artistike-shkencore (STEAM)*

Punimet artistike-shkencore kombinojnë **shkencën, artin dhe teknologjinë** për të komunikuar dhe ilustruar koncepte shkencore në mënyrë kreative dhe vizuale.

Ato përfshijnë:

- ✓ vizualizime artistike të fenomeneve shkencore;
- ✓ instalacione shkencore interaktive;
- ✓ animacione, video ose multimedia edukative;
- ✓ dizajn grafik dhe artistik i të dhënave;
- ✓ ndërthurje e estetikës me saktësinë shkencore.

Këto projekte ndihmojnë në zhvillimin e kreativitetit, komunikimit shkencor dhe mendimit ndërdisiplinor.

7. *Modele apo simulime 3D*

Projektet e kësaj tipologjie përfshijnë **krijimin e modeleve dhe të simulimeve tredimensionale** për të paraqitur struktura, procese ose sisteme shkencore në mënyrë vizuale dhe interaktive.

Projektet e kësaj tipologjie përfshijnë:

- ✓ modelim 3D të objekteve ose të sistemeve;
- ✓ simulime të proceseve fizike, biologjike ose inxhinierike;
- ✓ përdorim të softuerëve të dizajnit tredimensional;
- ✓ paraqitje të qarta vizuale për shpjegim didaktik.

Këto projekte ndihmojnë në kuptimin e koncepteve komplekse përmes vizualizimit.

8. Iniciativa komunitare me bazë shkencore

Iniciativat komunitare me bazë shkencore janë projekte që synojnë *përmirësimin e jetës në komunitet* përmes ndërhyrjeve të bazuara në prova dhe analiza shkencore.

Ato përfshijnë:

- ✓ identifikimin e një problemi komunitar (mjedisor, social, edukativ);
- ✓ mbledhjen dhe analizën e të dhënave;
- ✓ propozimin dhe testimin e zgjidhjeve;
- ✓ vlerësimin e ndikimit social ose ekologjik;
- ✓ ndërgjegjësimin e komunitetit.

Këto projekte forcojnë përgjegjësinë qytetare dhe lidhjen e shkencës me jetën reale.

FUSHA TË SUGJERUARA TË PROJEKTEVE

Për të siguruar një organizim të qartë, gjithëpërfshirës dhe të krahasueshëm të projekteve në kuadër të Festivalit Kombëtar të Shkencës, janë përcaktuar fushat e sugjeruara të projekteve. Këto fusha synojnë të orientojnë nxënësit dhe mësuesit koordinatorë në përzgjedhjen e temave dhe ideve të projekteve, duke reflektuar njëkohësisht kurrikulën e arsimit të mesëm të lartë, përparësitë kombëtare në profilet shkencore dhe tendencat bashkëkohore ndërkombëtare në fushat STEM dhe STEAM. *Fushat e mëposhtme nuk kufizojnë krijimtarinë e nxënësve*, por shërbejnë si kornizë orientuese për zhvillimin e projekteve kërkimore, eksperimentale, inxhinierike, teknologjike dhe ndërdisiplinore. Projektet mund të zhvillohen brenda një fushe të vetme *ose të ndërthurin disa fusha*, për sa kohë që ruajnë qartësinë shkencore, koherencën metodologjike dhe lidhjen me problematika reale të shkollës, komunitetit ose shoqërisë.

Fusha	Fokusi kryesor
Shkencat natyrore	Fizikë: Ligjet e lëvizjes dhe siguria rrugore, format e energjisë, burimet e rinovueshme dhe përdorimi efikasitet i tyre, energjia elektrike dhe përdorimi i sigurt i saj, drita dhe përdorimi i instrumenteve optike, ndikimi i ndriçimit në sigurinë vizuale në trafik dhe mjedis, valët akustike dhe masat mbrojtëse ndaj ndotjes, rrezatimet elektromagnetike dhe mbrojtja e shëndetit ndaj përdorimit të tyre, fizika moderne dhe teknologjitë bashkëkohore, studimi dhe eksplorimi i planetëve, yjeve dhe dukurive kozmike. Biologji: Biodiversiteti lokal, mikroorganizmat, shëndeti dhe ushqyerja, gjenetika bazë. Kimi: Reaksione kimike të përditshme, kimia e mjedisit, uji dhe ndotja, materialet ekologjike. <i>b)Për eksperimente dhe demonstrime interaktive:</i> Fizikë: Eksperimente mbi forcat, lëvizjen, energjinë, dritën, zërin dhe nxehtësinë, duke përdorur modele, pajisje dhe simulime interaktive për të ilustruar ligjet fizike në mënyrë vizuale dhe praktike. Kimi: Eksperimente të sigurta (për pH, tretshmërinë dhe reaksionet kimike vizuale; krahasim i materialeve sipas përçueshmërisë ose izolimit). Biologji: Rritja e bimëve në kushte të ndryshme (dritë, ujë, lloje të ndryshme të tokës), përdorimi i mikroskopëve për të vëzhguar qelizat e bimëve, mikroorganizmat e ujit ose pjesë të vogla të bimëve dhe kafshëve, përdorimi i sensorëve për të matur temperaturën, lagështinë, rritjen e bimëve ose aktivitetin e mikroorganizmave në kohë reale.
Inxhinieria dhe teknologjia	Ndërtim prototipesh, ura, makina të thjeshta, kulla dhe struktura model dhe testimi i qëndrueshmërisë së tyre, qarqe elektrike dhe energji diellore, sisteme ndriçimi, krijimi i pajisjeve për kursimin e energjisë dhe filtrimin e ujit; mekanizma të thjeshtë automatikë (hapje-mbyllje, ngritje-ulje); prototipe funksionale me materiale të ricikluara; modele të sistemeve mekanike dhe elektrike; zgjidhje

	teknike për probleme reale të shkollës (ndriçim, ventilim, siguri, ergonomi) etj.
IA dhe teknologjia digjitale	Krijimi i aplikacioneve të thjeshta për orare, informim ose orientim shkollor; robotë që ndjekin linja, shmangin pengesa ose reagojnë ndaj zërit; modele të thjeshta IA për klasifikim imazhesh, parashikime ose analiza të të dhënave; analiza e të dhënave të mbledhura nga sensorë; simulime digjitale të proceseve reale; projekte mbi përdorimin etik të inteligjencës artificiale në arsim dhe në shoqëri etj.
Shkencat e jetës dhe mjedisi	Projekte mbi rritjen e bimëve dhe sera inteligjente; monitorim i cilësisë së ajrit, ujit dhe tokës; studime mbi biodiversitetin lokal dhe ekosistemet urbane; analiza e ndikimit të ndotjes në shëndet; eksperimente mbi ushqimin, higjienën dhe stilin e jetesës; përdorim i sensorëve për matje mjedisore në shkollë dhe rreth saj; projekte mbi ndërgjegjësimin për shëndetin dhe mjedisin etj.
Matematika dhe shkencat e të dhënave	Modelim matematik i trafikut rreth shkollës; analiza statistikore; simulime probabilitare (lojëra, risqe, parashikime); vizualizim i të dhënave reale në grafikë dhe tabela; analiza e konsumit të energjisë ose ujit; parashikime të thjeshta (temperaturë, ndotje, prania e lagështirës); përdorim i Excel, GeoGebra, Desmos dhe mjeteve digjitale për analizë dhe interpretim etj.
Shkencat sociale	Anketime dhe studime mbi mirëqenien, shëndetin mendor, stresin dhe motivimin; analiza e përdorimit të teknologjisë dhe të rrjeteve sociale; studime mbi barazinë, përfshirjen dhe pjesëmarrjen qytetare; projekte që propozojnë përmirësime konkrete për jetën shkollë; analiza të sjelljeve sociale përmes të dhënave dhe grafikëve; lidhje e kërkimit social me rekomandime praktike për komunitetin etj.

Qëndrueshmëria dhe mjedisi i gjelbër	Modele funksionale të energjisë diellore, të erës dhe ujore; projekte për riciklim kreativ dhe ripërdorim materiale; analiza e konsumit të energjisë dhe ujit në shkollë; dizajn i shkollës së gjelbër; zgjidhje për uljen e mbetjeve dhe ndotjes; projekte për ndërgjegjësim mjedisor me ndikim real në komunitet; monitorim i ndryshimeve mjedisore në kohë etj.
STEAM (ndërdisciplinore)	Instalacione shkencore artistike që shpjegojnë fenomene natyrore; vizualizime të të dhënave përmes artit dhe dizajnit; animacione, video dhe multimedia edukative; dizajn grafik i koncepteve shkencore; modele 3D kreative; ndërthurje e artit, teknologjisë dhe shkencës për të komunikuar ide komplekse në mënyrë tërheqëse dhe të kuptueshme për publikun e gjerë etj.

VII. DOKUMENTI I SHKRUAR I PROJEKTIT NË KUADËR TË FESTIVALIT TË SHKENCËS

Dokumenti i shkruar i projektit në kuadër të Festivalit të Shkencës është pjesë përbërëse dhe e detyrueshme e pjesëmarrjes në Festivalin Kombëtar të Shkencës. Ai shërben për të pasqyruar në mënyrë të strukturuar idenë e projektit, procesin e punës, metodologjinë e ndjekur, rezultatet e arritura dhe reflektimin e nxënësve mbi punën e realizuar.

Çdo ekip i nxënësve është i detyruar të përgatisë dokumentacionin e projektit sipas formatit të përcaktuar më poshtë dhe ta paraqesë atë në të gjitha fazat e festivalit.

STRUKTURA E DOKUMENTIT TË SHKRUAR TË PROJEKTIT

Dokumenti i shkruar i projektit përbëhet nga këto rubrika:

1. Të dhëna të përgjithshme

- Titulli i projektit
- Emri i shkollës
- ZVAP / DRAP

- Emrat e nxënësve përbërës të ekipit (3–5 nxënës)
- Emri i mësuesit koordinator
- Fusha/t tematike sipas tabelës në kapitullin VI (*p.sh., shkenca natyrore, inxhinieri dhe teknologji, STEM/STEAM, IA, qënrueshmëria dhe mjedisi i gjelbër etj.*)

2. Përshkrimi i shkurtër i projektit

Një përmbledhje e qartë dhe koncize (maksimumi 150–200 fjalë) që shpjegon:

- idenë kryesore të projektit;
- qëllimin e projektit.

3. Problemi / Pyetja kërkimore

Në këtë pjesë përshkruhet qartë:

- problemi praktik ose çështja që trajtohet ose pyetja kërkimore që projekti synon të adresojë;
- konteksti ku shfaqet ky problem (në shkollë, në komunitet, në mjedis, në shoqëri etj.);
- arsyet pse ky problem është i rëndësishëm për t'u trajtuar.

4. Qëllimi dhe rezultatet e pritshme të projektit

- Qëllimi i përgjithshëm i projektit;
- 2–4 rezultate konkrete dhe të matshme që nxënësit synojnë të arrijnë përmes projektit.

5. Metodologjia e punës

Kjo pjesë duhet të pasqyrojë procesin e ndjekur nga ekipi dhe të përfshijë:

- hapat kryesorë të punës;
- metodat e përdorura (eksperimentale, kërkimore, inxhinierike, digjitale etj.);
- materialet, instrumentet, mjetet dhe teknologjitë e përdorura (varet nga tipologjia e projektit);
- mënyrën e mbledhjes dhe analizës së të dhënave (kur është e aplikueshme).

6. Zhvillimi i projektit dhe rezultatet

- përshkrimi i procesit të realizimit të projektit;

- rezultatet e arritura (produkte, prototipe, modele, të dhëna, zgjidhje);
- ilustrime, tabela ose grafikë (nëse ka).

7. Përfundime dhe reflektim

- çfarë u arrit përmes projektit;
- çfarë funksionoi mirë dhe çfarë mund të përmirësohet;
- çfarë kemi mësuar (nxënësit) nga ky proces.

8. Ndikimi dhe zbatueshmëria

- ndikimi i mundshëm i projektit në shkollë, në komunitet ose më gjerë;
- mundësitë për zhvillim të mëtejshëm ose zgjerim të projektit ose zbatime në praktikë.

9. Burimet dhe referencat

- libra, artikuj, faqe interneti, burime digjitale të përdorura;
- çdo burim duhet të citohet në mënyrë të përgjegjshme.

Udhëzime të përgjithshme për dokumentin

- Dokumenti i projektit duhet të jetë *i qartë, i strukturuar dhe i shkruar në gjuhë të kuptueshme*, duke përdorur terminologji të përshtatshme shkencore për nivelin e arsimit të mesëm të lartë.
- Përmbajtja e dokumentit duhet të *reflektojë punën reale të nxënësve*, procesin e zhvillimit të projektit dhe kontributin e ekipit.
- Dokumenti përgatitet nga *nxënësit, nën mbështetjen dhe orientimin e mësuesit koordinator*, pa zëvendësuar punën krijuese të tyre.
- Çdo burim informacioni i përdorur duhet të citohet, duke respektuar *etikën shkencore dhe autorësinë*.

Dokumenti i projektit duhet të plotësojë këto kërkesa teknike:

- Fonti: Times New Roman
- Madhësia e shkronjave: 12
- Hapësira ndërmjet rreshtave: 1.5
- Teksti i justifikuar
- Margjinat standarde (2.5 cm në të gjitha anët)

- Numërim faqesh

Dokumenti i projektit të shkruar do të jetë në çdo fazë të prezantimit të projektit.

VIII. PREZANTIMI I PROJEKTIT

Gjatë prezantimit të projektit në çdo fazë të Festivalit të Shkencës, por veçanërisht në fazën finale kombëtare, ekipi i nxënësve prezanton projektin sipas tipologjisë së tij në stendën e projektit të përcaktuar.

Stenda e projektit në Festivalin Kombëtar të Shkencës

Stenda e projektit përbën hapësirën fizike ku ekipi i nxënësve prezanton projektin e tij para jurisë, vizitorëve dhe të ftuarve. Ajo duhet të jetë e organizuar, funksionale dhe përfaqësuese e punës shkencore të realizuar, duke mundësuar komunikim të qartë të idesë, procesit dhe rezultateve të projektit.

1. Elementet e detyrueshme të stendës

Çdo stendë projekti duhet të përmbajë domosdoshmërisht:

- a) Poster shkencor (format A0) i vendosur në pozicion qendror dhe i lexueshëm, që përfshin:
 - titullin e projektit;
 - autorët (nxënësit), shkollën dhe mësuesin koordinator;
 - problemin/qëllimin e projektit;
 - metodologjinë e përdorur;
 - rezultatet kryesore (grafikë, tabela, figura, foto etj.);
 - zbatueshmërinë praktike.
- b) Dokumenti i shkruar i projektit (version i shtypur ose digjital) i vendosur në stendë për konsultim nga juria.
- c) Identifikimi i stendës me:
 - kodin e projektit;
 - emrin e shkollës;
 - kategorinë/fushën e projektit.

2. Materialet demonstrative dhe praktike

Në varësi të tipologjisë së projektit, stenda mund të përfshijë:

- Modele, prototipe ose pajisje funksionale (p.sh., ura model, robotë, sera inteligjente, pajisje matëse).
- Eksperimente ose demonstrime të sigurta që mund të realizohen gjatë prezantimit, pa rrezik për sigurinë.
- Sensorë dhe pajisje teknologjike për matje, monitorim ose kontroll (temperaturë, lagështi, dritë, lëvizje, etj.).
- Laptop / tablet / ekran për shfaqjen:
 - ✓ e simulimeve;
 - ✓ e aplikacioneve digjitale;
 - ✓ e analizave të të dhënave;
 - ✓ e videove shpjeguese të projektit.

3. Organizimi dhe paraqitja vizuale

Stenda duhet të jetë:

- e rregullt dhe e strukturuar;
- e pastër dhe estetike;
- me elemente vizuale që lehtësojnë kuptimin (skema, etiketa, ngjyra të moderuara);
- pa mbingarkesë informacioni;
- me materiale të qëndrueshme dhe të sigurta.

Rekomandohet përdorimi:

- ✓ i grafikëve të qartë;
- ✓ i ikonave dhe skemave shpjeguese;
- ✓ i titujve të dallueshëm.

4. Elemente të komunikimit shkencor

Stenda duhet të mundësojë:

- prezantim me gojë të strukturuar nga nxënësit (4 - 5 minuta);
- shpjegim të qartë të rolit të secilit anëtar të ekipit;
- përgjigje të argumentuara ndaj pyetjeve të jurisë;
- përdorim të terminologjisë shkencore të përshtatshme për nivelin e gjimnazit.

5. Rregulla sigurie dhe etike

Në stendë:

- ndalohet përdorimi i materialeve të rrezikshme;

- lejohen vetëm eksperimente të sigurta;
- respektohet etika shkencore dhe autorësia;
- të dhënat personale trajtohen në mënyrë të përgjegjshme;
- përdorimi i teknologjisë dhe IA bëhet në mënyrë etike dhe transparente.

6. Elemente shitesë (opsionale, por të rekomanduara)

- Broshura ose fletë informuese për projektin;
- QR code që lidh me:
 - ✓ projektin e plotë,
 - ✓ video prezantuese,
 - ✓ faqe digjitale të projektit;
- Elemente të vogla kreative që rrisin tërheqjen vizuale të standës.

Këto materiale shërbejnë për të përmbledhur qartë idenë, procesin dhe rezultatet e projektit dhe për të mbështetur prezantimin me gojë përpara jurisë dhe të ftuarve. Për t'u siguruar që stenda është në nivelin e kërkuar nxënësit dhe mësuesi koordinator mund të përdorë një listë kontrolli, shtojca 6 për përmbajtjen e standës në formën e vetëvlerësimit.

IX. EKIPI E NXËNËSVE DHE RREGULLAT E FESTIVALIT

Përbërja e ekipeve të nxënësve

Në Festivalin Kombëtar të Shkencës, çdo ekip nxënësish që merr pjesë, zhvillon dhe prezanton *një projekt shkencor* në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë udhëzues. Ekipi:

- krijohet që në fazën fillestare të procesit;
- e shoqëron projektin gjatë të gjitha fazave të festivalit (nivel shkolle, ZVAP-i, DRAP-i dhe në nivel kombëtar);
- përbëhet nga 3–5 nxënës të së njëjtës shkollë, të cilët mund të jenë nga një klasë ose nga klasa të ndryshme.

Çdo ekip mbështetet nga *një mësues koordinator* (i fushave të shkencave, teknologjisë ose TIK-ut), i cili orienton nxënësit gjatë zhvillimit dhe prezantimit të projektit, pa ndërhyrë në përmbajtjen shkencore të tij.

Parimet e përzgjedhjes së nxënësve në ekip

Përzgjedhja e nxënësve për ekipet pjesëmarrëse në Festivalin Kombëtar të Shkencës realizohet nga mësuesi koordinator, në bashkëpunim me drejtuesit e shkollës, duke u bazuar në aftësitë, interesat dhe prirjet e nxënësve për fushat shkencore, teknologjike dhe kërkimore. Procesi i përzgjedhjes duhet të jetë *transparent, gjithëpërfshirës dhe i drejtë*, duke garantuar mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit.

Ekipi i projektit duhet të reflektojë *diversitet aftësish, rolesh dhe përvojash*, të domosdoshme për zhvillimin, zbatimin dhe prezantimin e një projekti shkencor cilësor. Në këtë kuadër, inkurajohet veçanërisht *pjesëmarrja aktive e vajzave në fushat STEM/STEAM*, si dhe përfshirja e nxënësve nga *grupe të ndryshme shoqërore, kulturore ose gjeografike, përfshirë nxënësit me aftësi të ndryshme dhe nga zona të nënpërfaqësuar*.

Në përzgjedhjen e nxënësve rekomandohet të merren në konsideratë kriteret e mëposhtme:

- interesimi dhe motivimi për shkencën, teknologjinë dhe kërkimin shkencor;
- aftësia për të menduar në mënyrë kritike, analitike dhe krijuese;
- aftësia për të punuar në grup, për të bashkëpunuar dhe për të ndarë përgjegjësi;
- aftësitë praktike, eksperimentale, teknologjike ose organizative;
- aftësia për të prezantuar dhe argumentuar idetë përpara të ftuarve dhe jurisë.

Qëllimi i përzgjedhjes nuk është vetëm përfaqësimi i nxënësve me rezultate të larta individuale, por *ndërtimi i një ekipi funksional, bashkëpunues dhe të balancuar*, ku secili nxënës kontribuon sipas aftësive dhe rolit të tij. Kjo qasje nxit barazinë, zhvillon kompetencat sociale dhe qytetare dhe siguron përfshirjen reale të të gjithë nxënësve në procesin e të nxënësve dhe inovacionit shkencor.

Mësuesi koordinator

Mësuesi koordinator ka një rol të rëndësishëm në procesin e zhvillimit të projektit dhe në përgatitjen e ekipit për festivalin e shkencës. Në kuadër të projektit të shkencës ai/ajo:

- udhëzon nxënësit në formulimin e idesë dhe të qëllimit të projektit;
- mbështet zbatimin e metodës shkencore dhe organizimin e punës kërkimore;
- ndihmon në dokumentimin dhe strukturimin e projektit;
- përgatit nxënësit për prezantimin e projektit përpara jurisë.

Mësuesi koordinator nuk e zëvendëson punën e nxënësve, por vepron si lehtësues, këshillues dhe garant i cilësisë shkencore dhe pedagogjike të projektit.

Rregullat e pjesëmarrjes së ekipeve në festival

Gjatë gjithë zhvillimit të festivalit, ekipit e nxënësve janë të detyruara të respektojnë rregullat e mëposhtme:

- ✓ Projekti duhet të jetë produkt i drejtpërdrejtë i punës së nxënësve, i zhvilluar nën udhëheqjen e mësuesit koordinator, por pa zëvendësuar punën kërkimore dhe krijuese të nxënësve nga persona të tjerë.
- ✓ Çdo projekt duhet të dokumentojë qartë procesin e zhvillimit, nga ideja fillestare deri te produkti final, duke reflektuar hapat e ndjekur, vështirësitë, zgjidhjet dhe rezultatet.
- ✓ Ekipi duhet të ruajë të njëjtën përbërje gjatë të gjitha fazave të festivalit. Ndryshimi i përbërjes së ekipit nuk lejohet, përveç rasteve të justifikuara dhe të miratuara nga organizatorët përkatës.
- ✓ Prezantimi i projektit bëhet vetëm nga nxënësit përbërës të ekipit. Mësuesi koordinator nuk merr pjesë në prezantim dhe në intervistën me jurinë.
- ✓ Çdo projekt duhet të shoqërohet me materiale mbështetëse, në përputhje me natyrën e tij, të përshkruara në kapitullin VIII.
- ✓ Nxënësit duhet të respektojnë rregullat e sjelljes, etikës shkencore dhe sigurisë, gjatë përgatitjes dhe prezantimit të projekteve. Ndalohet përdorimi i materialeve, pajisjeve ose procedurave që paraqesin rrezik për shëndetin dhe sigurinë.
- ✓ Projektet që përfshijnë mbledhjen e të dhënave, eksperimente ose përdorim të teknologjisë duhet të respektojnë parimet e etikës, privatësisë dhe përdorimit të përgjegjshëm të teknologjisë.

Rregullat kryesore në lidhje me lëvizjen dhe pjesëmarrjen e nxënësve në fazën rajonale dhe kombëtare të festivalit

Për të garantuar sigurinë e nxënësve dhe zhvillimin normal të Festivalit Kombëtar të Shkencës, gjatë fazës rajonale dhe kombëtare duhet të respektohen rregullat e mëposhtme:

- Para pjesëmarrjes së nxënësve në fazën rajonale dhe kombëtare të festivalit, drejtorja e shkollës, në bashkëpunim me mësuesin koordinator, duhet të sigurojë

miratimin me shkrim të prindit/kujdestarit ligjor për pjesëmarrjen e nxënësit, sipas modelit përkatës (Shtojca 1).

- Ekipi i nxënësve shoqërohet gjatë udhëtimit dhe pjesëmarrjes në festival nga 1–2 mësues, ku njëri prej tyre është patjetër mësuesi koordinator i projektit; gjithashtu mund të jetë i pranishëm edhe një përfaqësues i ZVAP-it ose DRAP-it.
- Mësuesit shoqërues janë përgjegjës për:
 - plotësimin dhe dorëzimin e listës emërore të nxënësve pjesëmarrës, sipas modelit të përcaktuar (Shtojca 2);
 - mbikëqyrjen e nxënësve gjatë udhëtimit, qëndrimit dhe zhvillimit të aktivitetit;
 - respektimin e rregullave të sigurisë dhe të etikës gjatë gjithë kohëzgjatjes së festivalit.
- Nxënësit dhe mësuesit informohen paraprakisht nga organizatorët për:
 - programin dhe agjendën e ditës së festivalit;
 - rregullat e prezantimit të projekteve dhe të qëndrimit në ambientet e festivalit shkencor;
 - udhëzimet e përgjithshme të organizimit.
- Nxënësit duhet të paraqiten në vendin e zhvillimit të festivalit në orarin e përcaktuar, të ndjekin udhëzimet e organizatorëve dhe të qëndrojnë pranë stendës së projektit të tyre gjatë gjithë kohës së vlerësimit dhe prezantimit.
- Shkolla, në bashkëpunim me prindërit dhe mësuesit shoqërues, siguron transport të organizuar dhe të sigurt për nxënësit.
- Gjatë zhvillimit të festivalit, nxënësit duhet të respektojnë rregullat e sjelljes, të etikës dhe të sigurisë, si dhe të përfaqësojnë në mënyrë dinjitoze shkollën dhe institucionet arsimore që përfaqësojnë.

X. ROLI I INSTITUCIONEVE NË ORGANIZIMIN DHE NË ZHVILLIMIN E FESTIVALIT TË SHKENCËS

Organizimi dhe zhvillimi me sukses i Festivalit Kombëtar të Shkencës kërkon angazhimin e koordinuar dhe bashkëpunimin e strukturuar të aktorëve institucionalë në të gjitha fazat e procesit. Qartësimi i roleve dhe përgjegjësi të secilit aktor është i rëndësishëm për të garantuar transparencë, koherencë, cilësi dhe barazi në zbatimin e festivalit, nga niveli i shkollës deri në nivel kombëtar.

Ky kapitull përcakton rolin dhe përgjegjësitë e institucioneve dhe aktorëve të përfshirë, Ministrinë e Arsimit, ASCAP-in, AKAP-in DRAP-et, ZVAP-et, drejtuesit e shkollave, mësuesit koordinatorë duke theksuar funksionin e tyre në planifikimin, organizimin, monitorimin etj. Përmes një ndarjeje të qartë të roleve, synohet të sigurohet funksionimi i unifikuar i procesit, mbështetja e pjesëmarrjes së gjerë dhe gjithëpërfshirëse të nxënësve, si dhe garantimi i standardeve të cilësisë në zhvillimin e projekteve shkencore.

Përcaktimi i roleve në këtë kapitull synon gjithashtu të nxisë përgjegjshmërinë institucionale, bashkëpunimin ndërinstitutional dhe ndërtimin e një kulture të përbashkët pune, duke e shndërruar Festivalin Kombëtar të Shkencës në një proces të qëndrueshëm dhe të institucionalizuar në sistemin arsimor parauniversitar.

Ministria e Arsimit	• harton konceptin idenë e Festivalit Kombëtar të Shkencës, në përputhje me politikat kombëtare për zhvillimin e kompetencave STEM/STEAM në arsimin parauniversitar; • konsulton udhëzuesin kombëtar të Festivalit Kombëtar të Shkencës të hartuar nga ASCAP; • koordinon procesin duke garantuar standardet e cilësisë në të gjitha fazat e festivalit; • planifikon dhe siguron burimet financiare dhe logjistike të nevojshme për zhvillimin e festivalit sipas fazave përkatëse; • lehtëson bashkëpunimin me universitetet, sektorin privat dhe organizata të specializuara për përfshirjen e ekspertizës shkencore dhe teknologjike;
----------------------------	---

	• monitoron zhvillimin e festivalit, vlerëson projektet më të mira dhe ndërmerr masa për institucionalizimin e Festivalit Kombëtar të Shkencës si traditë vjetore e qëndrueshme.
Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP)	• harton dhe miraton udhëzuesin për organizimin dhe zhvillimin e Festivalit të Shkencës, si dhe kriteret e pjesëmarrjes dhe të vlerësimit të projekteve, të cilat shërbejnë për informimin dhe përgatitjen e nxënësve dhe mësuesve; • harton dhe standardizon formatet shoqëruese të festivalit (formularë pjesëmarrjeje, përshkrim projekti, fletë vlerësimi, raporte përmbledhëse etj.); • trajnon anëtarët e jurive në të gjitha fazat për zbatimin e kriterëve të vlerësimit të projekteve shkencore, me qëllim garantimin e një procesi të drejtë dhe profesional vlerësimi; • përfaqësohet në juri sipas fazave përkatëse; • monitoron zbatimin e udhëzuesit dhe të procedurave të Festivalit të Shkencës në të gjitha fazat e tij; • bashkëpunon me AKAP-in dhe institucionet e tjera përgjegjëse për ndjekjen dhe mbarëvajtjen e procedurave të Festivalit të Shkencës.
Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP)	▪ koordinon Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) dhe Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) për shpërndarjen dhe zbatimin e udhëzuesit për zhvillimin e Festivalit të Shkencës; ▪ orienton dhe mbështet koordinаторët vendorë dhe rajonalë për të gjithë procesin e organizimit të Festivalit të Shkencës, nga faza fillestare në nivel shkolle deri në fazën finale; ▪ harton, në bashkëpunim me koordinаторët vendorë dhe rajonalë, kalendarin e zhvillimit të Festivalit të Shkencës;

	▪ koordinon punën me DRAP-et dhe ZVAP-et për mbarëvajtjen e Festivalit të Shkencës dhe për zgjidhjen e çështjeve organizative dhe logjistike që lidhen me zhvillimin e tij; ▪ përfaqësohet në juri sipas fazave përkatëse; ▪ monitoron zbatimin e udhëzuesit dhe të procedurave të Festivalit të Shkencës në të gjitha fazat e tij; ▪ bashkëpunon me ASCAP-in dhe institucionet e tjera përgjegjëse për ndjekjen dhe mbarëvajtjen e procedurave të Festivalit të Shkencës.
Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar (DRAP)	• monitoron organizimin dhe zhvillimin e festivalit në nivel shkolle dhe ZVAP-i; • organizon Festivalin Rajonal të Shkencës me pjesëmarrjen e projekteve fituese nga ZVAP-të përkatëse; • emëron koordinatorin rajonal të festivalit; • përzgjedh dhe emëron anëtarët e jurisë rajonale; • garanton zbatimin korrekt të kriterëve të vlerësimit; • shpall projektet fituese që kualifikohen për fazën kombëtare; • bashkëpunon me MA, ASCAP-in dhe AKAP-in për organizimin e të gjitha fazave të Festivalit të Shkencës.
Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar (ZVAP)	• bashkëpunon me drejtuesit e shkollave të mesme publike dhe private për zbatimin e këtij udhëzuesi; • informon dhe mbështet shkollat për organizimin e fazës së parë të festivalit; • organizon Festivalin e Shkencës në nivel vendor, duke krijuar kushte për prezantimin dhe vlerësimin e projekteve; • emëron koordinatorin vendor dhe përfaqësuesin në jurinë e festivalit; • bashkëpunon me DRAP-in, AKAP-in dhe ASCAP-in për përbërjen e jurisë dhe procesin e vlerësimit; • koordinon lëvizjen dhe pjesëmarrjen e nxënësve në fazën rajonale dhe kombëtare, pas sigurimit të miratimeve përkatëse.

Drejtoritë e shkollave	• koordinon punën me mësuesit koordinator të fushave të shkencave, teknologjisë dhe TIK-ut për informimin dhe përgatitjen e nxënësve për Festivalin e Shkencës; • vë në dispozicion të mësuesve këtë udhëzues dhe siguron zbatimin korrekt të tij; • siguron materialet e nevojshme për realizimin e projekteve; • mbështet organizimin e aktivitetit në nivel shkolle (mini-panair shkencor) dhe krijon kushtet e nevojshme për prezantimin e projekteve; • monitoron procesin e përzgjedhjes së projekteve përfaqësuese të shkollës; • bashkëpunon me ZVAP-in për çështje që lidhen me organizimin, lëvizjen dhe transportin e nxënësve në fazat pasuese; • siguron dhe monitoron procesin e marrjes së miratimit me shkrim të prindërve/kujdestarëve për pjesëmarrjen e nxënësve në fazat vendore, rajonale dhe kombëtare të festivalit.
Mësuesi koordinator i projektit	• zbaton kërkesat dhe udhëzimet e këtij dokumenti në përgatitjen e projekteve; • identifikon dhe përzgjedh nxënësit përbërës të ekipeve, duke marrë në konsideratë interesat, aftësitë dhe prirjet e tyre në fushat shkencore, teknologjike dhe digjitale; • udhëheq nxënësit në hartimin, zhvillimin dhe dokumentimin e projektit shkencor; • mbështet nxënësit në përdorimin e metodës shkencore, teknologjisë, mjeteve digjitale dhe laboratorëve (p.sh. SmartLab), sipas natyrës së projektit; • monitoron punën e ekipit gjatë gjithë fazave të festivalit; • bashkëpunon me mësuesin kujdestar dhe drejtuesit e shkollës për sigurimin e miratimeve të nevojshme nga prindërit/kujdestarët;

	shoqëron ekipin e nxënësve gjatë fazave të festivalit në nivel ZVAP-i, DRAP-i dhe në fazën kombëtare.
--	---

XI. KRITERET DHE VLERËSIMI I PROJEKTEVE

Vlerësimi i projekteve në kuadër të Festivalit Kombëtar të Shkencës realizohet në mënyrë të strukturuar dhe bazohet në kriteret të unifikuara, të përcaktuara në këtë udhëzues. Procesi i vlerësimit synon të evidentojë cilësinë shkencore të projekteve, procesin e punës së nxënësve, krijimtarinë dhe aftësinë për të argumentuar dhe prezantuar zgjidhjet e propozuara. Vlerësimi kryhet nga juritë përkatëse në secilën fazë të festivalit (në nivel shkolle, ZVAP, DRAP dhe kombëtar), duke përdorur të njëjtën strukturë kriteresh, të përshtatur sipas nivelit të fazës.

a) Elementet që merren në konsideratë gjatë vlerësimit

Gjatë vlerësimit, juria merr në konsideratë:

- qartësinë e idesë dhe problemit të trajtuar;
- përdorimin e metodës shkencore dhe/ose zgjidhjes inxhinierike/digjitale.
- krijimtarinë dhe risinë e projektit;
- lidhjen e projektit me situata reale të shkollës, komunitetit ose shoqërisë;
- mënyrën e dokumentimit dhe të prezantimit;
- aftësinë e nxënësve për të argumentuar dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të jurisë.

b) Procedura e vlerësimit

Vlerësimi i projekteve realizohet përmes:

- shqyrtimit të dokumentacionit të projektit;
- vëzhgimit të prezantimit të projektit nga nxënësit;
- intervistës së shkurtër me ekipin e nxënësve;
- plotësimit të fletës së vlerësimit nga secili anëtar i jurisë.

Çdo anëtar i jurisë *vlerëson projektin në mënyrë individuale* sipas shtojcës 3. Rezultati përfundimtar i projektit përcaktohet nga mesatarja e pikëve të dhëna nga anëtarët e jurisë sipas shtojcës 4.

Projektet renditen në bazë të pikëve të grumbulluara të shënuara në procesverbalin e jurisë shtojca 5. Vetëm projektet që plotësojnë kriteret e përcaktuara dhe arrijnë

pragun minimal të vlerësimit kualifikohen për fazën pasuese të festivalit, *sipas numrit të projekteve të përcaktuara për çdo fazë.*

c) Kriteret e vlerësimit të projektit

Projekti në Festivalin Kombëtar të Shkencës do të vlerësohet sipas gjashtë kriterëve si më poshtë:

1. Risia dhe inovacioni

Ky kriter vlerëson shkallën e *originalitetit të idesë*, krijimtarinë në qasje dhe aftësinë e projektit për të sjellë zgjidhje të reja ose përmirësime domethënëse ndaj problemeve ekzistuese. Merret në konsideratë nëse projekti:

- ✓ propozon ide, koncepte ose zgjidhje që dallohen nga praktikat e zakonshme;
- ✓ kombinon njohuri nga fusha të ndryshme në mënyrë inovative;
- ✓ demonstroi mendim krijues dhe aftësi për të parë problemin nga këndvështrime të reja;
- ✓ shfrytëzon teknologjinë ose mjetet shkencore për të rritur vlerën inovative të projektit.

2. Zbatueshmëria praktike

Ky kriter vlerëson nëse projekti ka *potencial real për t'u zbatuar* dhe për të prodhuar ndikim praktik në shkollë, komunitet ose shoqëri. Në vlerësim merret parasysh:

- ✓ realizueshmëria e projektit në kushte reale;
- ✓ funksionaliteti i prototipit, modelit ose zgjidhjes së propozuar;
- ✓ qartësia e lidhjes midis problemit dhe zgjidhjes;
- ✓ qëndrueshmëria dhe mundësia e përmirësimit ose zgjerimit në të ardhmen.

3. Metodologjia shkencore

Ky kriter vlerëson *korrektësinë dhe strukturën shkencore* të projektit. Ai përfshin:

- ✓ qartësinë e qëllimit dhe/ose hipotezës;
- ✓ përzgjedhjen e metodave të përshtatshme kërkimore, eksperimentale ose inxhinierike;
- ✓ mbledhjen dhe analizën sistematike të të dhënave;

- ✓ përdorimin e saktë të koncepteve shkencore dhe nxjerrjen e përfundimeve të argumentuara;
- ✓ respektimin e etikës shkencore.

4. Prezantimi shkencor dhe argumentimi

Ky kriter vlerëson aftësinë e nxënësve për të *komunikuar qartë dhe bindshëm* projektin e tyre. Në vlerësim përfshihet:

- ✓ struktura dhe qartësia e prezantimit me gojë dhe vizual;
- ✓ përdorimi i terminologjisë shkencore të përshtatshme për nivelin e shkollës së mesme;
- ✓ aftësia për të argumentuar zgjedhjet metodologjike dhe rezultatet nëse një hipotezë mund të jetë vërtetuar apo jo;
- ✓ përgjigjet e qarta dhe të bazuara ndaj pyetjeve të jurisë;
- ✓ cilësia e posterit shkencor dhe materialeve mbështetëse.

5. Puna në ekip dhe kontributi i secilit

Ky kriter vlerëson *bashkëpunimin efektiv* brenda ekipit dhe përfshirjen aktive të të gjithë nxënësve. Vlerësohet:

- ✓ ndarja e qartë e roleve dhe përgjegjësi;
- ✓ kontributi real i secilit anëtar në zhvillimin dhe prezantimin e projektit;
- ✓ aftësia për të bashkëpunuar, komunikuar dhe zgjidhur probleme së bashku;
- ✓ respektimi i parimeve të barazisë, përfshirjes dhe përgjegjësisë kolektive.

6. Përdorimi i teknologjisë

Ky kriter vlerëson *përdorimin e qëllimshëm dhe efektiv të teknologjisë* në zhvillimin e projektit. Në vlerësim merret parasysh:

- ✓ integrimi i mjeteve digjitale, SmartLab-eve, sensorëve ose softuerëve;
- ✓ përdorimi i teknologjisë për mbledhje, analizë ose vizualizim të të dhënave;
- ✓ përdorimi etik dhe i përgjegjshëm i teknologjisë dhe inteligjencës artificiale;
- ✓ kontributi i teknologjisë në rritjen e cilësisë, inovacionit dhe zbatueshmërisë së projektit.

Secili kriter vlerësohet nga çdo anëtar jurie me 10 pikë. Pikët e jurisë llogariten si mesatare e pikëve të të gjithë anëtarëve të jurisë sipas formulës shtojca 4.

Nr.	Kriteri	Pikët maksimale	Pikët e dhëna nga çdo anëtar i jurisë	Pesha (në përqindje)
1	Risia dhe inovacioni	10	____/10	30%
2	Zbatueshmëria praktike	10	____/10	20%
3	Metodologjia shkencore	10	____/10	20%
4	Prezantimi shkencor dhe argumentimi	10	____/10	10%
5	Puna në ekip dhe kontributi i secilit	10	____/10	10%
6	Përdorimi i teknologjisë	10	____/10	10%
Total		60		100%

Projektet që nuk arrijnë të paktën 70% të pikëve të mundshme nuk kualifikohen për të kaluar në fazën pasuese.

Përshkrimi i niveleve për secilin kriter

Nivelet e vlerësimit të projekteve në kuadër të Festivalit Kombëtar të Shkencës janë përcaktuar për të siguruar një proces vlerësimi të drejtë, transparent dhe të standardizuar në të gjitha fazat e festivalit. Ato shërbejnë si orientim i qartë për komisionin në nivel shkolle dhe për juritë e të gjitha niveleve në vlerësimin e cilësisë së projekteve. Këto nivele orientojnë nxënësit në kuptimin e pritshmërive që lidhen me performancën shkencore dhe krijuese të projektit.

Përshkrimi i niveleve “Dobët”, “Mjaftueshëm”, “Mirë” dhe “Shumë mirë” bazohet në shkallën e përmbushjes së kriterëve të vlerësimit, në cilësinë e procesit kërkimor dhe në nivelin e demonstrimit të kompetencave shkencore, teknologjike dhe bashkëpunuese të nxënësve të arsimit të mesëm të lartë. Këto nivele reflektojnë jo

vetëm rezultatin përfundimtar të projektit, por edhe mënyrën e zhvillimit të tij, përfshirë risinë e idesë, zbatueshmërinë praktike, përdorimin e metodologjisë shkencore, argumentimin, punën në ekip dhe integrimin e teknologjisë.

Nivelet janë ndërtuar në përputhje me parimet e vlerësimit të kompetencave të nxënësve përmes projekteve dhe standardeve bashkëkohore të panairëve shkencore për nxënës, duke u përshtatur me moshën, kurrikulën dhe kushtet reale të shkollave të mesme. Përshkrimet e tyre synojnë të minimizojnë subjektivitetin në vlerësim, të garantojnë krahasueshmëri ndërmjet projekteve dhe të mbështesin një kulturë vlerësimi formuese dhe nxitëse për nxënësit.

Nr.	Kriteri	Niveli "Dobët" 0 - 4 pikë	Niveli "Mjaftuesëhm" 5 - 6 pikë	Niveli "Mirë" 7 - 8 pikë	Niveli "Shumë mirë" 9 - 10 pikë
1	Risia dhe inovacioni	Projekti bazohet kryesisht në ide të njohura dhe të përsëritura, pa elemente të reja ose qasje krijuese. Nuk evidentohen përpjekje për zgjidhje inovative ose përshtatje të ideve ekzistuese në një kontekst të ri.	Projekti përmban elemente të kufizuara risie, por ato nuk janë të zhvilluara plotësisht. Qasja inovative është e pjesshme dhe mbetet në nivel konceptual, pa ndikim të qartë në rezultatet përfundimtare.	Projekti paraqet ide krijuese dhe qasje të reja në trajtimin e një problemi. Evidentohen përpjekje për të dalë nga modelet standarde dhe për të propozuar zgjidhje të reja ose të përmirësuara.	Projekti demonstroi nivel të lartë inovacioni, ide origjinale dhe zgjidhje krijuese. Risia është e dukshme, e argumentuar dhe ka potencial për zhvillim të mëtejshëm ose zbatim në kontekste reale.
2	Zbatueshmëria praktike	Projekti nuk ofron zgjidhje praktike ose është i pabarizueshëm në kushte reale. Nuk lidhet me nevoja konkrete të shkollës apo të komunitetit.	Projekti paraqet një ide që mund të zbatohet pjesërisht, por ka kufizime të qarta në funksionim, ndikim ose realizim.	Projekti është i realizueshëm në praktikë dhe adreson një problem konkret. Ka ndikim të qartë në nivel shkolle ose komuniteti dhe mund të zbatohet	Projekti është plotësisht i zbatueshëm, funksional dhe me ndikim të dukshëm. Ai ofron zgjidhje të qëndrueshme dhe ka potencial për zgjerim ose replikim në kushte të tjera.

				me burime të arsyeshme.	
3	Metodologjia shkencore	Mungon metodologjia shkencore. Projekti nuk ka hipotezë të qartë, nuk përdor matje ose analiza dhe nuk ndjek hapa të strukturuar kërkimorë.	Projekti përfshin disa elemente të metodologjisë shkencore (vëzhgime, matje etj.), por ato janë të pjesshme dhe pa analizë të thelluar.	Projekti ndjek një metodologji të qartë dhe të strukturuar, përfshin mbledhje të të dhënave, analiza dhe interpretim logjik të rezultateve.	Projekti zbaton metodologji të plotë shkencore, me hipotezë të qartë, instrumente matëse të përshtatshme, analizë të saktë dhe konkluzione të argumentuara.
4	Prezantimi shkencor dhe argumentimi	Prezantimi është i paqartë dhe i çorganizuar. Argumentimi është i dobët, pa lidhje logjike dhe pa evidenca mbështetëse	Prezantimi është i kuptueshëm, por me strukturë të kufizuar. Argumentimi është i pjesshëm dhe jo gjithmonë i mbështetur në të dhëna.	Prezantimi është i qartë, i strukturuar dhe i mbështetur në evidenca. Nxënësit shprehen saktë dhe argumentojnë pjesërisht rezultatet e projektit.	Prezantimi është profesional, bindës dhe i rrjedhshëm. Argumentimi është i fortë, i bazuar në të dhëna dhe i komunikuar me terminologji shkencore të përshtatshme.
5	Puna në ekip dhe kontributi i secilit	Mungon bashkëpunimi në ekip. Kontributi i nxënësve është minimal dhe rolet nuk janë të përcaktuara.	Ka bashkëpunim i kufizuar. Disa anëtarë kontribuojnë më shumë se të tjerët dhe rolet nuk janë plotësisht të qarta.	Ekipi funksionon mirë, me bashkëpunim të rregullt dhe ndarje të roleve. Shumica e nxënësve kontribuojnë aktivisht	Ekipi është i organizuar në mënyrë strukturuar. Çdo anëtar ka rol të qartë dhe kontribuon në mënyrë të barabartë dhe aktive.
6	Përdorimi i Teknologjisë	Nuk përdoren pajisje teknologjike ose mjetet SmartLab nuk lidhen me projektin.	Përdorim bazik i teknologjisë, kryesisht për demonstrim dhe jo për analizë apo matje.	Përdorim korrekt dhe funksional i pajisjeve SmartLab ose mjeteve digjitale për mbledhje dhe analizë të të dhënave.	Përdorim i avancuar, kreativ dhe i qëllimshëm i teknologjisë, përfshirë sensorë, robotikë ose

					inteligjencë artificiale.
--	--	--	--	--	---------------------------

XII. ÇMIMET DHE FINALIZIMI I FESTIVALIT

Festivali Kombëtar i Shkencës finalizohet me organizimin e *prezantimit në nivel kombëtar të projekteve*, i cili zhvillohet në një mjedis të përshtatshëm dhe përfaqësues, ku ekspozohen projektet më të mira të përzgjedhura nga të gjitha rajonet e vendit. Festivali shërben si një hapësirë kombëtare për prezantimin publik të arritjeve shkencore dhe inovative të nxënësve të arsimit të mesëm të lartë, duke promovuar shkencën, teknologjinë dhe krijimtarinë si pjesë integrale të procesit arsimor.

Çdo ekip pjesëmarrës disponon *stendën e vet ekspozuese*, e organizuar sipas standardeve të përcaktuara në udhëzues, e pajisur me poster shkencor, materiale vizuale, prototipe, pajisje demonstrimi dhe elementë të tjerë prezantues që pasqyrojnë procesin, metodologjinë dhe rezultatet e punës kërkimore ose praktike të realizuar. Gjatë panairit, nxënësit prezantojnë projektet e tyre përpara *jurisë kombëtare*, përfaqësuesve institucionalë dhe të ftuarve, duke shpjeguar idenë e projektit, qasjen metodologjike, gjetjet kryesore dhe ndikimin e zgjidhjes së propozuar.

Në përfundim të prezantimeve dhe vlerësimit, *juria kombëtare shpall fituesit e Festivalit Kombëtar të Shkencës*, mbi bazën e kriterëve të unifikuara të përcaktuara në udhëzues, duke garantuar transparencë, objektivitet dhe krahasueshmëri në vlerësim.

Në përmbyllje të festivalit akordohen *çmime kryesore dhe çmime motivuese*, të cilat synojnë të vlerësojnë dhe të inkurajojnë arritjet më të spikatura shkencore dhe inovative. Çmimet lidhen, ndër të tjera, me projektin që demonstroi nivelin më të lartë të kërkimit dhe metodologjisë shkencore, projektin me risinë dhe inovacionin më të spikatur, projektin që sjell zgjidhje teknologjike me ndikim praktik në shkollë, komunitet ose mjedis, projektin që shquhet për punën bashkëpunuese dhe prezantimin shkencor cilësor etj..

Finalizimi i festivalit shërben jo vetëm si moment vlerësimi dhe celebrimi i punës së nxënësve, por edhe si një mundësi për *promovimin e talentëve të reja*, dokumentimin e praktikave të mira dhe nxitjen e pjesëmarrjes së mëtejshme në aktivitete kombëtare

dhe ndërkombëtare të shkencës dhe inovacionit. Festivali kontribuon kështu në ndërtimin e një kulture të qëndrueshme të kërkimit, inovacionit dhe bashkëpunimit shkencor në arsimin parauniversitar.

XIII. BIBLIOGRAFIA

European Commission (EUCYS). *European Union Contest for Young Scientists – Rules and Evaluation Criteria*.

Society for Science (2023). *Regeneron International Science and Engineering Fair (ISEF) – Student Handbook & Judging Criteria*.

UNESCO (2022). *Inquiry-Based Science Education (IBSE) and Project-Based Learning in Secondary Education*. UNESCO Publishing.

OECD (2023). *Innovating Education and Educating for Innovation*. OECD Publishing.

European Schoolnet (2021). *STEM and STEAM Education Practices in European Schools*. European Schoolnet.

UNESCO (2023). *Guidance on the Use of Artificial Intelligence in Education*. UNESCO. Manual me tema të projekteve kurrikulare “Matematikë”

<https://www.ascap.edu.al/.../Manual-projektet-matematike.pdf>

Manual me tema të projekteve kurrikulare “Fizikë” <https://www.ascap.edu.al/.../11/Manual-projektet-fizike.pdf>

Manual me tema të projekteve kurrikulare “Kimi” <https://www.ascap.edu.al/.../11/Manual-projektet-kimi.pdf>

Manual me tema të projekteve kurrikulare “Biologji” <https://www.ascap.edu.al/.../Manual-projektet-biologji.pdf>

Bett UK. <https://uk.bettshow.com/>

XIV. SHTOJCA

Shtojca 1

FORMULAR MIRATIMI NGA PRINDI/KUJDESTARI LIGJOR

Për pjesëmarrjen e nxënësit në Festivalin Kombëtar të Shkencës

Unë, i/e nënshkruari/a _____, prind/kujdestar ligjor i nxënësit/es _____, në shkollë _____, deklaroj se jam informuar mbi:

- qëllimin dhe përmbajtjen e Festivalit Kombëtar të Shkencës;
- fazat e zhvillimit të festivalit (nivel shkolle, ZVAP, DRAP dhe kombëtar);
- aktivitetet prezantuese, udhëtimet dhe pjesëmarrjen e nxënësit në panairin shkencor.

Me anë të këtij formulari, jap miratimin tim të plotë për pjesëmarrjen e fëmijës tim në Festivalin Kombëtar të Shkencës, si dhe për lëvizjen e tij/saj në kuadër të këtij aktiviteti, në përputhje me rregullat dhe udhëzimet e institucioneve përgjegjëse.

Jam në dijeni se nxënësi do të shoqërohet nga mësues përgjegjës dhe se shkolla do të marrë masat për sigurinë dhe organizimin e aktivitetit.

Data: _____

Emri dhe mbiemri i prindit/kujdestarit: _____

Nënshkrimi: _____

Nr. i kontaktit: _____

Shtojca 2

LISTA EMËRORE E NXËNËSVE PËR TRANSPORT

Data: _____

Destinacioni: Nga _____ në _____

Personi/at përgjegjës _____, _____

Nr	Emri dhe mbiemri	Shkolla	Klasa	Nr. cel i nxënësit	Nr. cel i prindit /kujdestarit
1					
2					
3					
4					
5					

Shtojca 3

FORMAT VLERËSIMI I PROJEKTIT NGA SECILI ANËTAR I JURISË

Fletë vlerësimi për çdo anëtar të jurisë

Emri i projektit: _____

Shkolla: _____

DRAP: _____

ZVAP: _____

Faza e festivalit: ☐ Shkollë ☐ ZVAP ☐ DRAP ☐ Kombëtare

Nr.	Kriteri	Pikë maksimale	Pikë të dhëna
1	Risia dhe inovacioni	10	___
2	Zbatueshmëria praktike	10	___
3	Metodologjia shkencore	10	___
4	Prezantimi dhe argumentimi shkencor	10	___
5	Puna në ekip	10	___
6	Përdorimi i teknologjisë	10	___
TOTAL		60	___/60

Komente të secilit anëtar të jurisë:

Emri i anëtarit të jurisë: _____

Nënshkrimi: _____

Data: _____

Shtojca 4

FORMAT VLERËSIMI I PROJEKTIT NGA JURIA

Fletë vlerësimi për jurinë

Emri i projektit: _____

Shkolla: _____

DRAP: _____

ZVAP: _____

Faza e festivalit: ☐ Shkollë ☐ ZVAP ☐ DRAP ☐ Kombëtare

Nr.	Kriteri	Pikë maksimale	Anëtari 1	Anëtari 2	Anëtari 3	Mesatarja e pikëve	Pesha (në %)	Pikët e fituara
1	Risia dhe inovacioni	10					30%	
2	Zbatueshmëria praktike	10					20%	
3	Metodologjia shkencore	10					20%	
4	Prezantimi shkencor dhe argumentimi	10					10%	
5	Puna në ekip dhe kontributi	10					10%	
6	Përdorimi i Teknologjisë/SmartLab	10					10%	
TOTAL		60					100%	

Komente të jurisë:

Emrat e anëtarit të jurisë dhe nënshkrimi:

a) _____

b) _____

c) _____

Data: _____

Formula për plotësimin e tabelës shtojca 4

$$Secili\ kriter(K) = \frac{anëtar1 + anëtar2 + anëtar3}{3}$$

$$Pikët\ totale\ të\ prjektit = K_1 \times 0.3 + K_2 \times 0.2 + K_3 \times 0.2 + K_4 \times 0.1 + K_5 \times 0.1 + K_6 \times 0.1$$

Shembull i tabelës së plotësuar nga juria. Pikët totale të projektit dalin deri në dy shifra mbas presjes dhjetore.

Nr.	Kriteri	Pikë maksimale	Anëtar 1	Anëtar 2	Anëtar 3	Mesatarja e pikëve	Pesha (në %)	Pikët e fituara
1	Risia dhe inovacioni	10	7	8	8	7,7	30%	2,30
2	Zbatueshmëria praktike	10	9	8	8	8,3	20%	1,67
3	Metodologjia shkencore	10	10	9	9	9,3	20%	1,87
4	Prezantimi shkencor dhe argumentimi	10	8	7	8	7,7	10%	0,77
5	Puna në ekip dhe kontributi	10	9	7	7	7,7	10%	0,77
6	Përdorimi i Teknologjisë/SmartLab	10	10	9	10	9,7	10%	0,97
TOTAL		60					100%	8,33

Shtojca 5

PROCESVERBAL I JURISË

Për përzgjedhjen e projekteve fituese

Sot, më datë _____, u mbledh juria e Festivalit të Shkencës në nivel

☐ ZVAP ☐ DRAP ☐ Kombëtar, e përbërë nga:

1. _____
2. _____
3. _____
4. _____

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, prezantimeve dhe vlerësimit sipas kriterëve të përcaktuara në udhëzuesin e ASCAP, juria vendosi projektet fituese si më poshtë:

Projektet fituese:

Nr.	DRAP	ZVAP	Shkolla	Kodi i projektit	Titulli i projektit	Nr. i pikëve të fituara

Ky procesverbal u hartua në ____ kopje dhe u nënshkrua nga të gjithë anëtarët e jurisë.

Emri dhe nënshkrimi i anëtarëve të jurisë:

Shtojca 6

LISTA E KONTROLLIT PËR NXËNËSIT

Kjo listë kontrolli përdoret nga nxënësit dhe mësuesit koordinatorë për të verifikuar që stenda e projektit plotëson të gjitha kërkesat e Festivalit Kombëtar të Shkencës.

1. Identifikimi i stendës

- ☐ Titulli i projektit është i dukshëm dhe i qartë
- ☐ Emri i shkollës është i shënuar
- ☐ Kategoria/fusha e projektit është e specifikuar
- ☐ Kodi i projektit është i vendosur në stendë

2. Poster shkencor (A0)

- ☐ Posterit është në format A0
- ☐ Përmban titullin, autorët dhe mësuesin koordinator
- ☐ Paraqet qartë problemin/qëllimin
- ☐ Shpjegon metodologjinë e përdorur
- ☐ Përfshin rezultate me grafikë/tabela
- ☐ Përmban përfundime dhe zbatueshmëri
- ☐ Posterit është i lexueshëm dhe i rregullt vizualisht

3. Projekti i shkruar

- ☐ Projekti i shkruar është i pranishëm (print ose digjital)
- ☐ Struktura është sipas udhëzuesit
- ☐ Gjuha dhe terminologjia janë të sakta
- ☐ Referencat janë të cituara

4. Materialet demonstrative

- ☐ Prototipi/modeli funksionon siç është parashikuar
- ☐ Eksperimentet janë të sigurt
- ☐ Pajisjet SmartLab janë të instaluar dhe funksionale
- ☐ Pajisjet teknologjike (laptop, tablet) janë të karikuar

5. Prezantimi nga nxënësit

- ☐ Prezantimi është i përgatitur (5–7 minuta)
- ☐ Secili nxënës njih rolën e tij
- ☐ Nxënësit janë të aftë të shpjegojnë procesin dhe rezultatet

6. Siguria dhe etika

- ☐ Nuk përdoren materiale të rrezikshme
- ☐ Respektohet autorësia e projektit
- ☐ Përdorimi i teknologjisë/ AI është etik dhe i deklaruar

Përfundim

- ☐ Stenda është gati për vlerësim
- ☐ Ekipi është i përgatitur për prezantim